

LIGJ
Nr. 149/2015

**PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES SË HUAS
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT PËR
ZHVILLIM ABU DHABI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BULEVARDIT VERIOR
DHE TË REHABILITIMIT TË LUMIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet dokumenti ndryshues i marrëveshjes së huas ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të Bulevardit Verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9381, datë 6.1.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

FONDI PËR ZHVILLIM ABU DHABI

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Ref. 373

Datë 4.3.2014

Shkëlqesisë së Tij, Z. Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Republika e Shqipërisë

Tel. +355 4 2228405

Shkëlqesia Juaj,

Lënda: Projekti i Rehabilitimit të Bulevardit Verior dhe Lumit të Tiranës, Republika e Shqipërisë

I referohemi mbledhjes së zhvilluar në zyrat tona, në datën 5 shkurt 2015, me pjesëmarrjen e Shkëlqesisë së Tij, ambasadorit Shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe përfaqësuesit të Bashkisë së Tiranës, në emër të përfituesit në lidhje me projektin e subjektit dhe shkresën me numër protokolli 2280, të datës 11.2.2014, që jep sqarime të mëtejshme në skedulin II të Marrëveshjes.

Në vijim të diskutimit tonë dhe marrëveshjes së përbashkët dhe dhënies së pëlqimit të përfituesit të

projektit, Bashkisë së Tiranës, ne kemi rishikuar skedulin II të Marrëveshjes për të reflektuar gjendjen aktuale të projektit siç është parashikuar në fazën e vlerësimit të tij. Ju bëjmë me dije se ky rishikim nuk do të ndikojë në termat dhe kushtet e projektit dhe as nuk do të ketë ndonjë ndikim financiar në marrëveshjen e huas dhe skedulin në fjalë, të ndryshuar, të cilat mbeten subjekt i marrëveshjes së huas të nënshkruar më herët në datën 21.4.2013.

Bashkëlidhur gjeni 3 grupe të skedulit II të rishikuar. I lutemi Shkëlqesisë Suaj të nënshkruajë të gjithë kopjet, të mbajë një prej grupeve dhe të na ktheni 2 grupet e tjera.

Me respekt
Mohammed Saif Al Suwaidi
Drejtore i Përgjithshëm

SKEDULI II “I NDRYSHUAR”

1. Objektivat e projektit

Objektivi i projektit është që të ndihmojë në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit përmes zhvillimit të Bulevardit Verior të Tiranës, përmirësimit të ujëmbledhësit dhe bregut të Lumit të Tiranës si edhe mbështetjes së investimeve, objektivave/ambienteve të kohës së lirë dhe turizmit në zonë.

2. Përshkrimi i projektit

Projekti konsiston në ndërtimin real të objekteve të mëposhtme:

- Rehabilitimi i shtratit të lumit, i bregut dhe zonave të afërta;
- Ndërtimi i zonës së Bulevardit dhe punimet civile të lidhura me të;
- Ndërtimi i rrugës së Unazës;
- Përgatitja e infrastrukturës për rritjen e turizmit dhe për lehtësimin dhe tërheqjen e ndërtimit të objektivave tregtare.

Kontributi i Fondit do të mbulojë plotësisht rehabilitimin e lumit dhe bregut të tij, ndërtimin e bulevardit verior (pjesa e parë) dhe shërbimet e konsulencës teknike të përshkruara në raportin e vlerësimit të projektit, të cilat përfaqësojnë 50% të të gjithë projektit. Pjesët e tjera të projektit që përbëhen kryesisht nga rruga e unazës, pjesa e dytë e bulevardit, punimet infrastrukturore etj., do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës.

3. Lista e mallrave

Nr.	Zëri	Shuma	% e financimit
1	Punime rehabilitimi të lumit dhe bregut të tij dhe të gjitha punët civile dhe të ndërtimit të lidhura me to	90 000 000	100%
2	Ndërtimi i zonës së bulevardit dhe punimet civile të lidhura me të (pjesa e parë)	120 000 000	100%
3	Shërbime teknike dhe të konsulencës	10 000 000	100%
4	Kontingjencat e projektit	20 000 000	100%
	Totali	240 000 000	100%

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Shkëlqim Cani
Ministër i Financave

Për Fondin për Zhvillim Abu Dhabi
Mohammed Saif Al Suwaid
Drejtore i Përgjithshëm